



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.07.2016, ora 18:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit datë 15.07.2016.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i disa propozimeve për ndryshime në tekstin e Projektit Kushtetues të miratuar nga Komisioni i Posacem Parlamentar në datën 14 qershor 2016

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Petrit Vasili dhe Vexhi Muçmata.

Mungon:

Oerd Bylykbashi, Spartak Braho, Keltis Kruja, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Rainer Deville – ekspert i Nivelit të Lartë, shef i misionit të EURALIUS-it në Shqipëri
John Smibert – ekspert i Nivelit të Lartë, përfaqësues i misionit të OPDAT-it në Shqipëri

Aurela Anastasi - eksperte e Nivelit të Lartë

Sokol Sadushi - ekspert i Nivelit të Lartë

Gent Ibrahimimi - ekspert i Nivelit të Lartë

Fatmir Xhafaj – *(mungesë incizimi)* Kjo mbledhje ishte programuar për dje, por meqenëse është duke u zhvilluar një proces negociatash, me idenë që ky proces mund të mbyllet sot, u detyruam ta shtyjmë për ditën e sotme. Natyrisht, procesi nuk është përmblyllur ende plotësisht, është në vazhdim për ato dy çështje që janë pjesë e negociimit politik për të gjetur një zgjidhje në funksion të nevojës apo të përpjekjes për të arritur një konsensus në miratimin e projektit kushtetues.

Gjithsesi, për efekt të Rregullores, jemi të detyruar ta mbledhim komisionin për të reflektuar këto ndryshime, ashtu siç janë sot, sepse na e imponon Rregullorja që ky proces të përmbillet formalisht dy ditë para seancës dhe më pas është seanca që vendos nëse ka dakordësi me sukses, që do të mund të bëjë ndryshime në një konsensus të plotë të palëve.

Mbledhja e sotme është e domosdoshme për t'i hapur rrugë seancës së ditës së enjte, sepse, siç e bëri të njohur publikisht pak kohë më parë edhe Kryetari i Kuvendit, ka nënshkruar rendin e ditës së ditës së enjte duke e përcaktuar si pikë të parë të rendit të ditës, diskutimin dhe miratimin e amendamenteve kushtetuese.

Ka lindur e nevojshme për shkak të disa refleksioneve të bëra nga grupet parlamentare, nga debati politik në Kuvend, por edhe nga përpjekjet e palëve politike të përfshira në proces dhe e përpjekjeve të partnerëve ndërkombëtarë për të gjetur një konsensus, që disa nene të projektit ekzistues të hiqen tërësisht nga projekti. Ato janë kryesisht nenet e kapitullit të parë dhe njëkohësisht, të ndryshojnë disa nene që kanë të bëjnë me formulat e KLGJ-së, KLP-së dhe të vetingut.

Dua të bëj të qartë që në fillim, se këto nuk janë definitive, sepse për rastin e vetingut është dhënë formula e propozuar nga zonja Nuland në emër të SHBA-së dhe BE-së, si zgjidhje konsensusi, por kjo është ende në proces negociimi. Nuk do të ketë ndryshim thelbësor të asaj formule (kjo është e sigurt), sepse palët e kanë pranuar të gjitha që ajo është formula më e përshtatshme dhe janë të gjithë dakord në parim, por mund të ketë disa nuanca, të cilat më pas do të reflektohen gjatë ditës së nesërme apo gjatë seancës. E rëndësishme është që projekti në tërësi me ndryshimet, të jetë i miratuar nga pikëpamja procedurale për t'i hapur rrugë seancës plenare.

Mund të vazhdojmë me një prezantim të shkurtër të projektit.

Do ta bëni ju, zonja Hysi?

Më pas, do të vazhdojnë edhe ekspertët.

Ju lutem, një paraqitje të projektit në mënyrë të përmbledhur!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Amendimet që keni përpara në tryezë dhe që shoqërojnë këtë relacion, bazohen në draftin e ndryshimeve kushtetuese, të cilat i kemi diskutuar dhe miratuar në mbledhjen e datës 14 qershor 2016. Nëse ju kujtohet, pavarësisht miratimit të projektligjit nga komisioni, disa anëtarë të komisionit kanë pasur mendime dhe diskutime të ndryshme në lidhje me disa çështje të caktuara të parashikuara në të. Në funksion të nevojës për të gjetur një konsensus dhe që të reflektojmë në projekt disa nga sugjerimet që kishin edhe kolegët e opozitës, por edhe ne, është zhvilluar në vijimësi një proces intensiv negociatash midis përfaqësuesve të maxhorancës dhe opozitës, lidhur me këto çështje të kundërshtuara apo për të cilat janë ndarë mendime të ndryshme. Padyshim, unë do të doja edhe ndihmën e ekspertëve ndërkombëtarë në këtë proces me qëllim që ne si maxhorancë dhe kolegët e opozitës të shkojmë drejt një konsensusi përfundimtar, lidhur me projektin kushtetues.

Në fakt amendimet që propozohen janë paraqitur në 3 grupe.

Në grupin e parë janë disa amendime për pjesën e dispozitave, që lidhen me integrimin europian. Kështu në versionin e rishikuar të projektit të amendimeve kushtetuese janë hequr dispozitat që lidhen me integrimin europian, më përjashtim të neneve 43 dhe 73 të Kushtetutës. Ky amendim që bëhet është në vijim të qëndrimeve të disa grupeve politike parlamentare në Komisionin Parlamentar të Reformës në Drejtësi. Nëse ju kujtohet, shpesh kolegët e opozitës theksonin se këto dispozita nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me sistemin e drejtësisë dhe se vendosja e dispozitave me natyrë hipotetike në trungun e Kushtetutës nuk është e përshtatshme nga ana e teknikës legislative. Natyrisht, e gjithë puna që është bërë, që është vlerësuar nga Komisioni i Venecias për hartimin e këtyre dispozitave, nuk do të humbasë. Ato do përdoren për reformat e ardhshme kushtetuese.

Gjithashtu, te neni 33 të projektligjit, i cili ndryshon nenin 147 të Kushtetutës, është rishikuar, duke reflektuar negociatat politike lidhur me mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve jogjyqtarë në Këshillin e Lartë gjyqësor, të zgjedhur nga Kuvendi. Pikërisht, negociatat dhe rezultati i tyre janë kthyer në një gjuhë normative dhe kjo është mënyra më e përshtatshme për të garantuar pjesëmarrjen e opozitës parlamentare në procesin e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit. Është propozuar krijimi i një komisioni të posaçëm parlamentar me 10 anëtarë, i cili nëpërmjet

metodës së votimit të njohur si vota e vetme e transferueshme, përzgjedh kandidatët të cilët miratohen nga Kuvendi.

Së treti, neni 49 i projektligjit, i cili ndryshon nenin 149 të Kushtetutës, është rishikuar për të reflektuar zhvillimet e negociatave politike lidhur me mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve joprokurorë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi. Rezultat i këtyre negociatave është kthyer në gjuhën normative dhe është i tillë për të garantuar pjesëmarrjen e opozitës parlamentare në procesin e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit. Konkretisht, sugjerohet krijimi i një komisioni të posaçëm parlamentar me 10 anëtarë, i cili nëpërmjet metodës së votimi, i njohur si vota e vetme e transferueshme, përzgjedh kandidatët, të cilët miratohen nga Kuvendi sipas sugjerimit të dhënë në paragrafin 88 të raportit përfundimtar të Komisionit të Venecias.

Së katërti, edhe neni 54 i projektligjit të ndryshimeve kushtetuese, i depozituar në parlament, që shton në Kushtetutë nenin 149, “d”, ka pësuar disa ndryshime, të cilat janë të natyrës redaktoriale dhe ju në projektin që keni përpara i keni të shënuara me ngjyrën blu.

Së pesti, neni 56 i projektligjit, që ndryshon nenin 179 të Kushtetutës, ka pësuar disa ndryshime:

1. Në nenin 179 është hequr paragrafi 9, pasi ai u referohet dispozitave tashmë të hequra në kreun e parë; flitet për dispozita që lidhen me integrimin evropian, pra flasim për dispozitën kalimtare.

2. Paragrafi 12 i nenit 179 i projektit të Kushtetutës është numërtuar 11 për shkak të heqjes së paragrafit 9. Gjithashtu, në këtë paragraf janë bërë disa ndryshime redaktoriale, të cilat i keni të shënuara me ngjyrën blu.

3. Paragrafi 14 është bërë paragrafi 13 për shkak të heqjes së paragrafit 9. Gjithashtu, aty janë reflektuar ndryshimet që janë bërë në formulat e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të anëtarëve të organeve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Paragrafi 13 i këtij neni parashikon mënyrën e zgjedhjes për periudhën transitore vetëm të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.

Së gjashti (flasim për aneksin që shoqëron projektin e ndryshimeve kushtetuese), në nenin “b” të aneksit janë bërë disa saktësime dhe ndryshime redaktoriale, të shënuara me germa me ngjyrën blu, ndërsa në nenin “c” të aneksit janë reflektuar ndryshimet e artikuluar në

propozimin e zonjës Viktoria Nuland, ndihmësekretare e Departamentit Amerikan të Shtetit. Këto ndryshime konsistojnë në katër drejtime:

Së pari, njohin një rol të rëndësishëm të operacionit ndërkombëtar të monitorimit në procesin e verifikimit të integritetit dhe aftësive profesionale të anëtarëve të organeve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve.

Së dyti, mbajnë parasysh rekomandimin e paragrafit 88 të Komisionit të Venecias dhe pasqyrojnë dakordësinë e partnerëve tanë, e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Europian.

Së treti, njohin rolin substancial të opozitës në procesin e propozimeve të organeve të rivlerësimit.

Së katërti, respektojnë parimin e sovranitetit të Kuvendit të Shqipërisë në zgjedhjen e organeve të rivlerësimit dhe në vendimmarrjen e tyre.

Të nderuar kolegë, mbështetur në nenin 177 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në vendimin nr. 96 të vitit 2014 të Kuvendit të Shqipërisë “Për krijimin e komisionit të posaçëm parlamentar”, i cili ka si objekt kryesor rishikimin e Kushtetutës dhe legjislacionit në drejtim të institucioneve që lidhen me drejtësinë, paraqesim amendimet sipas tekstit, bashkëlidhur këtij relacioni.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – A ka ndonjë shtesë nga ekspertët? Zoti Smiber.

Jon Smibert – (*përkthen përkthyesja*) Unë dua të bëj 3 korrigjime të vogla.

E para, ka të bëjë me propozimin e zonjës Nuland, e cila është në pikën “c”, paragrafi 14. Këtë e kam diskutuar me disa nga kolegët këtu dhe ka një ndryshim të vogël në versionin shqip për prezantimin e dokumentacionit për propozimin e zonjës Nuland ku thuhet që është faza e fundit dhe është refuzimi i listës me 2/3-at për të ndaluar procesin. Pra, është një proces 2-hapësh. E kam diskutuar me kolegët dhe ka një problem gjuhe që reflektohet aty, përkthimi në shqip. Ndoshta për ta bërë atë të plotë dhe të përputhshme me propozimin real, propozoj që të bëhet ndryshimi në përkthimin e gjuhës shqipe.

E dyta, janë nja dy vende në nenin 147. Kolegu im, zoti Deville më përcaktoi aty që në një fjali thuhet “përzgjedhja e njerëzve me anë të votës transparente” dhe pastaj thuhet “numri më i madh i votave”. Mund të kuptohet që në fund të fjalisë së dytë të thuhet në përputhje me ligjin. Pra, që procesi të jetë transparent duhet të jetë më i plotë. Këtë e kam diskutuar dhe me

kolegët e mi dhe ndoshta është më e arsyeshme që ta bëjmë këtë ndryshim. Ta shtojmë aty në fund të fjalisë së dytë që të bëhet sipas ligjit. Pra, votimi të jetë transparent dhe sipas ligjit.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Zoti Deville.

Rainer Deville – *(përkthen përkthyesja)* Më lejoni të bëj 3 vërejtje. Është bërë një ndryshim i vogël ku janë hequr vlerat europiane. Kjo është diçka e papëlqyeshme. Në nenin 80 keni hequr pjesën kryesore që ka të bëjë me të drejtat njerëzore. Keni fshirë aty pjesën e të drejtave njerëzore. Vërejtja e parë.

Vërejtja e dytë ka të bëjë me humbjen e 5 shtyllave tona duke përfshirë noterinë, Shkollën e Magjistraturës, për të pasur një përfaqësim të gjerë me përfaqësues të ndryshëm që kanë një rol në gjyqësor, ose që janë të lidhur me gjyqësorin. Tashmë në draft kuptojmë që dy nga këto shtyllat janë hequr këtu. Në nenin “b” të aneksit keni ndryshuar përcaktimin për monitorimin pas ndryshimit dhe marrëveshjes që është bërë me Brukselin. Atë çka shikoj aty nuk e gjej të implementueshme, sepse keni parashikuar që monitorimi ndërkombëtar duhet të shqyrtojë, të vërtetojë, të kontrollojë të gjitha asetet e kandidatëve, por vëzhguesit ndërkombëtarë nuk i kanë mjetet për t’i bërë këto vëzhgime ose kontrole, apo nuk kanë edhe kapacitetin për t’i bërë të gjitha këto kontrole. Mendoni sikur të kemi një numër të lartë aplikimesh dhe të gjitha këto kandidatura duhet që të bëjnë deklarimin e aseteve të tyre, pronës së tyre, por edhe duhen kontrolluar. Pra, duhet një burim i madh njerëzor dhe do të kishte më shumë kuptim në qoftë se do të shtonim këtu që ta përmirësonim pak a shumë ligjin, sepse gjuha paraqet vështirësi dhe pas rishikimit me Brukselin. Jo të gjitha ndryshimet i janë referuar Brukselit. Ajo çka është hequr normalisht nuk është e dukshme në draft. Prandaj doja t’i përcaktoja këto 3 vërejtje.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Dua të bëj një sqarim. Për sa u përket neneve që janë te kapitulli i parë ne theksuam dhe për një pjesë të tyre dhe unë personalisht do t’i mbështesja fort, por gjatë gjithë kësaj kohe ka pasur një debat parlamentar me reagime të ndryshme lidhur me mandatin e komisionit. Zëra të grupeve të ndryshme politike parlamentare janë shprehur për faktin që komisioni ka dalë tej mandatit të tij për rishikimin e Kushtetutës për çështjen që lidhen me sistemin e drejtësisë. Dhe në kushtet e këtij qëndrimi dhe në kushtet e nevojës për të pasur një konsensus sa më të gjerë ne i konsideruam si zgjedhje më të pranueshme që një pjesë të mirë të neneve të kapitullit të parë, me

dhimbje, por në funksion të qëllimit që ka procesi dhe nevoja që kemi për konsensus rreth tij, t'i heqim nga teksti për t'i bërë pastaj me siguri pjesë në një kohë të dytë, kur ta çmoj parlamenti shqiptar që t'i përfshijë në një ndërmarrje tjetër reformuese kushtetuese. Por për momentin ato le të ngelen një pasuri e parlamentit, për t'u trajtuar në kohën e përshtatshme. Unë jam dakord me ndryshimet që mund të janë bërë gjatë përkthimit ose kalimit të materialit dhe mund të reflektohen këtu, siç u tha te neni 19, tek aneksi "c" dhe "b".

Për sa u përket atyre që lidhen me formulat, me zgjedhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, vetingut dhe rolit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, janë në proces negocimi. Ne thjesht po reflektojmë situatën e sotme dhe për aq konsensus sa është sot. Natyrisht, e theksova edhe në fillim, kjo i hap rrugë seancës së të enjtes nga pikëpamja procedurale. Në rast se nuk e bëjmë këtë veprim sot, nuk do të kemi seancë të enjten dhe do të jemi të detyruar të shkojmë me projektin e mëparshëm, që mund të krijonte më shumë probleme dhe për këtë arsye po bëjmë këtë hap procedural. Për ato që janë në proces negocimi sot, nesër dhe pasnesër do të reflektohen nëse do të kenë konsensusin e të gjitha palëve, dhe me siguri do ta kenë, sepse është kusht bazë dhe mundësia më e mirë për ta votuar konsensualisht këtë reformë kushtetuese. Më pas do të reflektohen me më pak ndryshime, ashtu siç do të çmohet të rezultojë nga negociatat ndërmjet faktorëve politikë dhe partnerëve ndërkombëtarë të përfshirë, që janë një komponent i fortë i këtij procesi negocimi. Për këtë arsye kërkoj mirëkuptimin tuaj për të vazhduar më tej!

Për vërejtjet që bëri zoti Devil dua të kem mirëkuptim të plote, por për t'ju sqaruar edhe ju, edhe kolegët, ky është një proces i hapur, që mund të reflektojë nuancat e negocimit në draftin kushtetues. Mund të reflektohen nesër, pasnesër, gjatë seancës, kjo është një çështje që nuk jemi në gjendje të themi se kur do të kemi një produkt konsensual. Detyra jonë është kjo. Pjesa tjetër i takon parlamentit dhe nga sot kjo është në pronësi të seancës. Seanca thotë: "Bëjmë pushim", ka ndodhur, mblidhet Komisioni i Posaçëm, reflekton negocimin dhe ia paraqet seancës. Prandaj është ngritur një Komisioni i Posaçëm, që ka edhe procedura të posaçme.

Keni gjë tjetër?

Vasilika Hysi – Kryetar, kam unë diçka.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

Vasilika Hysi – Të them të drejtën, pajtohem me shqetësimet e zotit Rajner për heqjen e dispozitës që parashikon plotësim të nenit 18, paragrafi i dytë i Kushtetutës, i cili flet për liritë dhe të drejtat e njeriut.

Kjo reformë është për t'u ardhur në ndihmë dhe në mbështetje të qytetarëve për t'u shërbyer atyre dhe në themel ka parimet e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, të gjitha protokollet shtesë dhe direktivat e Bashkimit Europian për respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Ndihem e keqardhur që ka deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, të cilët nuk janë dakord për të parashikuar në Kushtetutë dy motive që janë prezent në Shqipëri, mbi bazën e të cilave diskriminohet grupi i LGBT-ve, konkretisht identiteti gjinor dhe orientimi seksual dhe, për hir të kësaj, të djegim dhe të heqim nga Kushtetuta bazat e tjera me të cilat ndalohej diskriminimi.

Për shembull, janë një sërë plotësimesh: aftësia e kufizuar, përkatësia prindërore, gjendja ekonomike, pasurore, arsimore.

Dakord, mund të pranohet, sepse duhet të votojmë këtë Kushtetutë dhe të mos e djegim reformën në drejtësi, pasi kolegët në parlament nuk duan orientime seksuale, identitete gjinore, por të mos i biem më qafë grupeve të tjera, të cilët kanë të drejtë të gëzojnë liritë dhe të drejtat e tyre.

Gjithashtu, edhe ajo që kemi parashikuar, “Interesi më i lartë i fëmijës”, unë nuk e gjej absolutisht me logjikë që të hiqet. Në nenin 54 është shtuar një paragraf ku thuhet: “Interesi më i lartë i fëmijës ka përparësi në të gjitha çështjet e lidhura me të”.

Grupet e punës kanë përgatitur, me mbështetjen e CEF-it një kod për të drejtat e fëmijëve. Ne kemi ratifikuar Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës. Unë nuk e kuptoj çfarë konsensusi dhe çfarë negociatash arrihen të bëhen duke hequr interesin më të lartë të fëmijës. Ne nuk po zgjedhim llokat se kush do të zgjedhë anëtarët jogjyqtarë ose anëtarët joprokurorë, por po flasim për një detyrim që kjo qeveri dhe çdo qeveri që do të vijë më pas, në të gjitha nismat dhe hapat duhet të mbrojnë interesin më të lartë të fëmijës, që deri më sot nuk e ka mbrojtur.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Vasilika Hysi – Do të doja që ky amendim të mos miratohet. Këto dy gjëra i kam shumë të rëndësishme. Në qoftë se do të bëjmë veto, ta bëjmë nëse nuk futet kjo ose ajo dispozitë.

Ndihem shumë e keqardhur që një parlament, që do ta çojë Shqipërinë në BE, është kundër standardeve elementare.

Fatmir Xhafaj – Zonja Hysi, edhe unë jam shumë i keqardhur, po aq sa ju, sepse është një punë 20-mujore, në të cilën është përshirë kontributi i të gjithëve, në mënyrë të veçantë i ekspertëve, por edhe yni në këto amendamente. Unë kam qenë dhe mbetem partizan i amendamenteve, jo vetëm i atyre që thatë ju, por edhe i amendamenteve të tjera. Por këtu nuk është një lëvizje selektive për arsyet që thatë ju se po hiqen këto dispozita. Këtu nuk është çështja e identitetit gjinor apo orientimit seksual, që është shkaku. Absolutisht jo. Këtu janë hequr edhe një sërë dispozitash të tjera. Ashtu siç ju jeni mbrojtëse e flaktë e këtyre amendamenteve, jam edhe unë për këto amendamente, por edhe për një sërë amendamentesh të tjera, sepse i kam mbrojtur me shumë pasion.

Ka një logjikë, që e ka përdorur një pjesë e grupeve politike parlamentare, ku thonë: “Mandati juaj ka qenë për këtë gjë, shtyjeni në kohë, në një moment të dytë, kur mund të bëhen ndryshime të tjera kushtetuese apo ligjore, dhe le t’i bëjmë pjesë të një projekti tjetër”. Më duket se ky është një arsyetim bindës, sepse është e vërtetë se kemi kaluar përtej mandatit që kemi pasur dhe duhet ta pranojmë këtë gjë. Nuk ka asgjë të keqe që po ndodh kjo, se nuk është fundi i botës.

Vasilika Hysi - Zoti kryetar, nënet që unë përmenda, ndjesë që po e marr fjalën përsëri, nuk kanë të bëjnë thjesht me integrimin evropian, ato janë themeli...

Fatmir Xhafaj - Nuk kanë të bëjnë me reformën në drejtësi.

Vasilika Hysi - Ato janë bazamenti i të gjithë paketës së ligjeve, pra të 50 ligjeve që ne po bëjmë në kuadër të reformës në drejtësi. Këto duhet të jenë parimet bazë, që do të udhëheqin ndryshimet në Kodin Penal, në Kodin e Procedurës Penale, Kodin Civil, Kodin e Familjes dhe kudo. Prandaj, nëse biem dakord për të kënaqur dëshirat e kolegëve në parlament, që nuk janë të përgatitur për identitetin gjinor dhe për orientimin seksual, që nuk kanë të bëjnë as me martesën dhe as me birësimin, të paktën të mos djegim pjesën tjetër. Për një plesht, ne po djegim të gjithë jorganin!

Fatmir Xhafaj - Zonja Hysi, unë e kuptoj pasionin dhe përkushtimin tuaj për këtë gjë, por do t’ju lutesha që të më mirëkuptoni mua dhe kolegët, këtu është fjala për të respektuar një mandat që Kuvendi na e ka dhënë dhe na e ka kufizuar për t’u fokusuar dhe për të qenë të përqendruar te reforma në drejtësi. Këtu nuk ka paragjykime e të tjera.

Po, zoti Vasili.

Petrit Vasili - Të them të drejtën, sinqerisht jam jo pak i surprizuar që ne kemi mbi tavolinë një tekst kaq të gjerë me propozime për amendamente. Sigurisht, për hir të shpjegimit korrekt që bëri zoti Xhafaj, për arsye të procedurave, për arsye të procesit politik, që ndërkohë ecën, dhe për një pjesë të tyre disa reflektime nga ana procedurale vazhdojnë t'i japin hapësirë asaj që duam të arrijmë për një konsensus, praktikisht mund të pranoheshin. Megjithëse për këtë çështje, po them sinqerisht, ne jemi duke përpiluar ndryshime kushtetuese dhe sido që të ishte puna duhet të kishim pasur një minimum dakordësie në këtë sallë, të paktën për respekt të komisionit, të hartuesit, të propozuesit apo të atyre që ishin të mandatar për të negociuar një gjë të tillë, që duhet të ishin për të dhënë shpjegimet e tyre, propozimet e bëra të jenë të ekuilibruara dhe të ruajnë soliditetin e ndryshimeve kushtetuese. Pra, të kishim mundësi të bënim bashkëbisedimin e zakonshëm që komisioni bën me hartuesit. Praktikisht kemi një seri propozimesh, që vijnë, sigurisht, nga një negocim politik, që do të thotë nga diku, por nuk kemi autorët e tyre. Kjo sigurisht krijon një problem procedural, por edhe formal.

Gjithashtu, edhe ndryshimet e tjera që bëhen këtu, sinqerisht po ju them se jam i keqardhur, edhe për disa vërejtje që u referuan, që janë të karakterit të të shkruarit, mënyra të riformulimit, probleme të gjuhës, në fund të një procesi kaq të gjatë, me mobilizim e ekspertëve që ne i pagëzuan "të nivelit të lartë" (një ekspertizë e nivelit të lartë, në radhë të parë dhe, mbi të gjitha, do të thotë një ekspertizë profesionale, më e mira që mund të ekzistojë, e cila mund të pranojë të gjitha llojet e problematikave të karakterit politik e të tjerë) por të tilla problematika nuk mund t'i pranoj dhe nuk mund të vijnë këtu në tavolinë tonë për t'u diskutuar.

Së treti, më shqetëson ajo që tha zoti Rajner, lidhur me operacionin ndërkombëtar. Avokatia që i është bërë këtij operacioni ndërkombëtar ka qenë dhe mbetet një dhe e vetme, e cila është bërë publike nga mjaft përfaqësues politikë, të cilët i janë dedikuar kësaj gjëje. Edhe në opinionin publik ideja e krijuar është shumë e qartë, që të gjithë këtë material të madh dhe të gjithë këtë lëndë të madhe do ta marrë operacioni ndërkombëtar, do ta skanojë dhe në fund do të përpilojë rezultatin.

Sot dëgjojmë se operacioni ndërkombëtar ka kapacitet të kufizuara. Kjo kërkon një reflektim serioz, sepse ne e kemi paraqitur dhe e kemi marrë përsipër në publik. Nuk i kam marrë me vete, por mund të sillja citime pa fund, ne kemi krijuar një pritshmëri publike që në këtë punë ne të gjithë do të jemi shumë të qetë dhe të gjithë qytetarët do të jenë shumë të qetë, se këtë

proces do ta marrin të huajt në dorë. Personalisht nuk e kam besuar asnjëherë që një volum kaq të madh pune do të mund ta merrte përsipër dhe do ta bënte operacioni ndërkombëtar, për të gjithë ato pamundësi teknike për të cilat Rajneri i tha dhe unë i bashkëndaj, pra jam në një mendje me të. Por ne jemi këtu pasi e kemi nënshkruar në Kushtetutë, pasi kemi bërë tonelata të tëra avokati publike, si mund t'u themi shqiptarëve, kur u thamë se gjithë këtë punë do ta bëjnë të huajt, që ata tani nuk do ta bëjnë dot? Sigurisht, ata janë përsëri shumë të dobishëm, por do të bëjnë një punë të organizuar ndryshe, të selektuar, ashtu siç u takon. Mbase rastet që do të jenë të dyshimta do të kërkojnë një verifikim tjetër nga ana e tyre, se punë organizmi është kjo, por ama jemi para një pritshmërie të re. Kjo nuk mund të dalë sot, dy ditë para se të shkojmë në sallën parlamentit, sepse kjo kundërshton të gjitha ato që ne kemi thënë në publik, pasi, për fat të keq, këtu është bërë një betejë shumë e madhe publike, e cila ka krijuar pritshmëri të larta, por në disa raste ka krijuar pritshmëri të pamundura, siç është rasti konkret.

Sigurisht që edhe në këtë pikë, kjo do të kërkonte një reflektim shumë të fortë në relacion, çdo ndryshim që do t'i bëhej kësaj pike, që është kaq delikate, sepse ne të gjithë e dimë, që një nga pikat më të debatuar është roli, misioni, mënyra e vendosjes së operacionit ndërkombëtar, raporti i tij me Kushtetutën e të tjera, që kanë mbajtur ndezur një debat, që e mbajnë gjallë sot e kësaj dite. Ju e kuptoni fare mirë, që edhe këtë që kemi miratuar, sepse në datën 5 korrik, ne e kemi miratuar këtë, ngritëm dorën të gjithë së bashku, sot themi se kemi disa paqartësi, apo kemi gjëra që duhen sqaruar. Më falni, por, unë, personalisht, nuk ndihem mirë në këtë pikë. Unë mendoj se nga të gjitha pikat, ku ne mund të mos qëndrojmë gjatë, këtu duhet të qëndrojmë dhe më duket serioze ajo që sapo tha zoti Rainer.

Gjithashtu, edhe për qëndrimin e nenit 18, debati im ka të bëjë me korrektesën drejt procedurave, nuk ka të bëjë me bindjen time nëse jam dakord apo jo me heqjen, ky është një debat tjetër; mund të jem dakord me ata që e kanë propozuar, por nuk është kjo çështja. Çështja është që edhe në qoftë se do të rindërtonim, pra të hiqnim dorë nga ajo që kemi miratuar të gjithë së bashku, duhet të kishim, së paku, një relacion, ose një kërkesë të motivuar mirë, me disa arsye të tjera, me shumë argumente, që të na bindin, që atë që votuam, në një farë mënyre, ta ç'votojmë. Së paku, në respekt të punës shumë të mirë që komisioni po bën prej kaq kohësh, duhet ta bëni. Ju besoj jeni në një mendje me mua, që për rekordet e punës së këtij komisioni, do të duhet të jepeshin arsye, edhe formale, se pse ne u tërhoqëm nga një gjë që kemi miratuar, sepse formalisht ne e kemi. Në *site-in* e Parlamentit, qytetarët kanë mundur të konsultojnë një

projektkushtetutë të miratuar nga ne, e cila ka një lëndë tjetër. Kushdo i interesuar që do të vinte të kërkonte sqarime apo shpjegime për punën e komisionit, do të kërkonte se nga ç'letër e shkruar u nisëm për këtë punë, kush erdhi për të na dhënë argumentimet e tij, që ta bindnin komisionin; mund të bindesha, unë jam nga ata njerëz që bindem dhe do të isha dakord, por kjo kërkon një punë të tillë.

E fundit, por e rëndësishme për mënyrën se si ne i qasemi problemit, ne kemi pasur një debat shumë të fortë për sa i takon paketës për ligjet e integritit, për nenet që kishin lidhje me këtë gjë.

Ne bëmë këtu një debat të nxehtë, sepse edhe opozitën e kemi pasur në atë kohë. Me thënë të drejtën, eksperiencia, ndoshta edhe për punë të tjera, sepse kjo punë është edhe një eksperiencë, një gjë e rëndësishme, (fitojmë një thesar nga eksperiencia që kemi), në nisma të tjera që do të kemi, do të na bëjë t'ia kursejmë vetes ato që mund të shmangen që në fillim.

Vetëm për këtë nen kemi harxhuar, dhe ju e mbani mend, sepse kemi qenë të gjithë këtu, gati 1 orë e gjysmë, apo 2 orë, nuk e di se sa, diskutime: pse t'i mbajmë, pse t'i heqim. E bëmë debatin, i futëm në draft, tani kthehemi dhe i heqim.

Pra, dua të them që në disa raste duhet të jemi edhe më fleksibël, sepse kjo na ndihmon për të evituar fleksibilitetin, për të na evituar kthimin pas. Sinqerisht, unë kthimin pas, pas një debati kaq të gjatë, e kam të dhimbshëm, sepse them cila ka qenë koha, motivet, motivimi politik për ta votuar, ndërkohë që detyrohem dhe tërhiqem përsëri.

Për sa i përket raportit me opinionin, të gjithë do të detyrohemi të shkojmë lart e poshtë, sepse merremi me politikë, do të shkojmë nëpër studio televizive, do të shpjegohemi, do të pyetemi dhe unë do të jem i varfër në argumentimin që të them: në mbledhjen e ditës së sotme ne u tërhoqëm, përjashtuar ato që janë pjesë e negociimit politik, që kanë një tjetër strukturë qasjeje, edhe politike, edhe kushtetuese, nuk po merrem me atë pjesë, por edhe për shumë e shumë të tjera, aq më pak, do ta kem të pamundur të bëj qoftë edhe një shpjegim, kur të më pyesin: po defektet e karakterit teknik, apo përmirësime, apo korrektive, apo përmirësime të gjuhës?

Sot, dy ditë para, ne nuk mund të flasim për probleme përkthimi. Kjo është punë e një stafi teknik, nuk është puna jonë. Që nga kryetari e të gjithë ne të tjerët, nuk e kemi për detyrë këtë. Diçka këtu nuk ka funksionuar.

Pra, rezervat lidhur me këtë proces, unë i formuloj duke pasur të gjithë dashamirësinë që këto t'i konsiderojmë si gjëra, të cilat nuk duhet të na përsëriten. Ndoshta ne mund të mblidhemi

në mënyrë të vazhdueshme, sepse ky është ende një proces, nuk e shoh të mbyllur, por, së paku, për gjëra të tilla duhet të nxjerrim mësimet tona.

Ndërsa për sa i përket çështjes së operacionit ndërkombëtar të monitorimit, besoj se duhet të qëndrojmë, pasi në qoftë se e kemi këtë problematikë, të gjitha riformulimet lidhur me të duhet të jenë shumë të kujdesshme dhe të menduara mirë, pasi do të thotë të korrektojmë, të ndreqim, të prekim një nen, i cili është demonstruar si një nen problematik, që ka mbajtur gjallë një debat të madh.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Faleminderit, zoti Vasili!

Jam i detyruar të kem një reagim për disa nga çështjet që u trajtuan prej jush, edhe në cilësinë e kryetarit të komisionit, por edhe të njeriut përgjegjës për këtë proces, për ta koordinuar dhe për ta organizuar këtë punë. Natyrisht, edhe nëse ka diçka që nuk shkon, unë bej pjesë tek ata njerëz që thonë: “Ndjesë, mund të ishte bërë më mirë” dhe nuk ka asgjë të keqe. Ky është një proces voluminoz, me shumë tension, me shumë stres, me shumë ngarkesë e me shumë të panjohura. Natyrisht, ka edhe gjëra që mund të mos shkojnë ashtu siç duhet në një moment të caktuar, pa i hyrë çështjes së ligjit tekst, për të cilin e kam thënë dhe e them, unë nuk kam lexuar deri më sot në karrierën time modeste ndonjë ligj perfekt. Pse ky që kemi të jetë perfekt?

Për sa u përket pjesëve që lidhen me organizimin e procesit dhe me këtë të sotmen dua të them se ato që u trajtuan nga pikëpamja, si e kuptova unë dhe si e justifikova zotin Smajber, është fakti që këto janë përgatitur në shqip. Ndërkohë, po punohet paralelisht edhe në anglisht, për shkak se ky është një proces me partnerë dhe ne jemi të detyruar të kemi një lloj certifikimi, e para, për të parë standardet dhe për një punë të përbashkët, sepse amendimet që bëjnë, janë amendime të një pune të përbashkët dhe në këtë proces mund të ketë gjëra që mbeten duke kaluar sa në një tërësi në tjetrën.

Po t'i vini re me shumë kujdes, ato janë ndërhyrje shumë të vogla shumë teknike, që nuk e prekin thelbin. Janë thjesht reflektime të këtij kalimi të shkëmbimit të dokumenteve. Kjo nuk lidhet me projektin bazë që kemi dorëzuar në Kuvend. Me këtë që po shqyrtojmë sot, janë defekte të sotme. Në momentin e zbardhjes, siç ndodh shpeshherë, do të reflektohen që të mos përsëriten më. Besoj se këtu kam mirëkuptimin tuaj në këtë aspekt.

Nuk është mirë që të ndodhin, sepse edhe këshilltaret tona dhe sekretarja teknike këtë detyrë kanë, por ngarkesa e ditës ka qenë e tillë që e ka imponuar këtë gjë, për arsyen e thjeshtë, sepse ne ishim shumë shpresëplotë që do të mbyllej procesi i negociatave dhe do ta kishim mundësinë t'i reflektonim në mënyrë të plotë dhe të menjëhershme gjithçka që dëshironim për seancën.

Nuk e arritëm dot dhe punuam në kushtet e mosmbylljes së negociatave dhe kalimi nga një draft në tjetrin e krijon këtë problem.

Së dyti, lidhur me nenet e BE-së ose që lidhen në ato që quhen nene të integritit, është e vërtetë që ka pasur një debat jo të vogël edhe këtu.

Unë besoj që ato mund të kishin qëndruar, por ju jeni dëshmitar edhe i faktit që grupe politike dhe kryesisht në grupe politike të opozitës, por edhe të maxhorancës, që të jemi korrekt, nuk është çështje opozicioni politik, kanë shfaqur rezerva lidhur me futjen e këtyre amendamenteve.

Natyrisht, ka edhe kontestime që kanë të bëjnë me thelbin, por një pjesë e konsiderueshme janë edhe kontestime, që kanë të bëjnë me formën ose më saktë me të drejtën tonë për t'i përfshirë këto.

Natyrisht, ne i përfshimë, sepse kishim bindjen si komision, por grupet politike gjykuam dhe kanë bërë këtë vërejtje dhe kanë paralajmëruar që nuk do ta votojnë projektin sa kohë që ka një tejkallim të mandatit të tij. Ne gjykuam që këtë reflektim ta bëjmë që këtu në komision sesa në sallë dhe kemi mundësinë t'ia heqim një debat të tepërt seancës plenare.

Për sa i përket rolit të monitorimit ndërkombëtar unë nuk e kuptova zotin Rajner kështu si ju. Unë vazhdoj të mendoj që operacioni i monitorimit ndërkombëtar i ka gjithë përgjegjësitë që i takojnë të ketë, por, nga ana tjetër, kjo është një çështje, që është pjesë e negociatave dhe është duke u diskutuar.

Pra, dy janë çështjet që janë duke u negociuar në dijeninë time dhe besoj se edhe ju keni të njëjtin informacion.

Së pari, është roli dhe sa do të mbajë përgjegjësi misioni ndërkombëtar? Sa do të jetë i angazhuar në këtë proces dhe sa do të jetë i përfshirë në kornizën kushtetuese dhe sa do të jetë i përfshirë në kornizën ligjore?

Elementi i dytë që është duke u negociuar, ka të bëjë me çështjen e formulës së vetingut duke ruajtur si bazë formulën konsensuale të paraqitur nga ndihmës zëvendëssekretarja

amerikane e shtetit, që është një formulë e një përpjekje, një propozim i Shteteve të Bashkuara dhe BE-së partnerë të këtij procesi për të gjetur një zgjidhje konsensuale.

Bie dakord me ju që ata që janë pjesë e negocimit politik do të rrinë kështu. Ne jemi sot. Nesër uroj të bëhet sa më shpejt, se aq më mirë është edhe për ne, sepse për të bërë reflektimet kushtetuese nuk është gjë e lehtë dhe këtu besoj se biem dakord edhe bashkë që sa më shpejt të mbyllet dhe të negociohet, siç tha me të drejtë edhe Kryetari i Kuvendit në mesditë, sikur për gjysmë ore, për një orë, për dy orë, jo thjesht dhe vetëm do të ç'tensiononte klimën politike dhe do ta përgatiste opinion politik dhe publik për votimin, por do të na lehtësonte edhe ne për reflektimin e tyre, sepse edhe një negociatë politike ta reflektosh në një normë kushtetuese, pa dyshim, që nuk është e lehtë, sepse mund të bësh një lëvizje, e cila mund të krijojë efekte kaskadë te nenet e tjera kushtetuese, sepse heq një paragraf që ka një numërtim, duhet të ndryshosh disa paragrafë që të reflektojnë atë ndryshim.

Do Zoti dhe le të shpresojmë të gjithë që do të mbarojmë që sot, që të kemi mundësinë edhe nesër të bëjmë një reflektim shumë më profesional që të mos ndodhin këto defekte si këto që evidentuan vetë ekspertët apo që i nënvizuat edhe ju. Le të shpresojmë të bëhet më e mira.

Zoti Devil, urdhëroni!

Rainer Devil – *(përkthen përkthyesja)* Mund të kthehem pak te neni “b”, 3a, ku bëme një ndryshim, ku bëme komentet. Dua të sugjeroj që të kthehemi te versioni origjinal me ndryshimin që rekomandimet t’i kalojnë Kuvendit dhe të shtojmë “në përputhje me rregullat e parashikuara me ligj”, sepse atëherë do të keni mundësinë për ligjin e vetingut, të organizojmë atë çka është e nevojshme për të pasur një skenar të duhur, i cili nuk varet nga Kushtetuta, sepse si do të funksiononte. Pra, nga teoria në praktikë duhet të kishim pak më shumë hapësirë për implementimin tij, nuk duhet të jetë një mjet detyrues, i cili del si pengesë për Kushtetutën. Pra, i gjithë parashikimi që është aty për selektimin e kandidatëve, për pozicionin e anëtarit të komisionerit si gjykatës dhe komisioner publik do të shtojmë “në përputhje me rregullat e parashikuara në ligj”. Më pas këtë mund ta rregullojmë në ligj atë që shkon për këtë gjë.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Sipas parashikimeve në ligj është...

Rainer Deville – *(përkthen përkthyesja)* Pra, duhet të jetë “sipas rregullave të parashikuara me ligj”.

Fatmir Xhafaj – Sipas rregullave, sipas ligjit, nuk ka ndonjë ndryshim.

Në rregull.

I marrim nen për nen.

Jeni dakord me nenin 1, që të hiqet?

(Diskutime pa mikrofon)

E ke te ligji bazë.

Neni 2? Dakord.

Neni 3? Dakord.

Neni 4? Dakord.

Neni 5? Dakord.

Neni 6, siç është? Dakord.

Neni 7 hiqet.

Neni 8 hiqet.

Neni 9 ndryshohet si më poshtë.

Neni 10 hiqet.

Neni 11 hiqet.

Neni 12 hiqet.

Neni 34 me vërejtjen e paraqitur nga Xhon? Dakord.

Neni 14? Dakord.

Neni 15? Dakord.

Neni 16/56 “Për Bankën e Shqipërisë”, hiqet.

Neni 17/ 57, që bën ndryshimet te neni 179? Dakord.

Neni 18, me ndryshimin e propozuar nga zoti Deville, i cili është për t’u reflektuar?

Dakord.

Neni 19, me ndryshimin teknik të kërkuar nga zoti Smaibert dhe që ka mirëkuptimin edhe të ekspertëve të tjerë? Dakord.

Këto janë.

Jeni dakord? Po.

Në tërësi? Dakord.

Zonja Hysi, faleminderit edhe për mirëkuptimin tuaj! Isha i sigurt që do ta kisha në votën përfundimtare në tërësi.

Faleminderit!

Kisha edhe diçka të fundit. Pasi të përgatitet edhe raporti për seancën, i cili do të përgatitet sot, duhet të punojmë mbi këtë bazë.

Jeni dakord me raportin dhe tekstin që do t'i paraqitet seancës? Dakord.

Çfarë u tha këtu të reflektohen, edhe ato që u miratuan që t'i paraqiten seancës.

Kam një propozim për projektvendimin. Zoti Vasili, do t'ju lutesha të kisha vëmendjen tuaj, për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar, sepse në datën 27 korrik afati i komisionit mbaron dhe ai mund të gjendet para nevojës që të ketë mbledhje të tjera, jam i bindur dhe këtë nuk e diskutoj fare, sepse është paketa ligjore e të tjera. Të vëmë një maksimum, 5 muaj.

A biem dakord? Dakord.

Miratohet.

E mbyllim mbledhjen edhe për sot.

I uroj suksese zotit Smibert dhe zotit Deville që të negociojnë me sukses, pasi kanë edhe mbështetjen tonë, për ta përmbyllur me shpresë të Zotit sot ose maksimumi nesër në mëngjes, që të kemi mundësinë gjatë ditës së nesërme të reflektojmë që të mos shkojmë në seancë me ndonjë keqkuptim, qoftë edhe të natyrës teknike.

Ju falënderoj të gjithëve!

Faleminderit kolegëve!

Faleminderit ekspertëve!

Faleminderit sekretariatit teknik!

Faleminderit stafit tonë të mrekullueshëm dhe pa dyshim edhe zonjave të përkthimit dhe zotërinjve të teknikës! Faleminderit! Natën e mirë!

Do të mbetemi në kontakt.

MBYLLET MBLEDHJA

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë